

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegj i përbërë nga Gyltene Sylejmani, kryetare e kolegjit, Erdogan Haxhibeqiri dhe Beshir Islami, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: N. A., J. A., A. A., B. A., A. A. dhe S. A., që të gjithë nga fshati ..., komuna e ..., të cilët me autorizim i përfaqëson av.F. N. nga ..., kundër të paditurës K. e S. "S.", me seli në ..., të cilën me autorizim e përfaqëson K. P., për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas revizionit të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.4741/2015, të datës 17.09.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 03.03.2020, mori këtë:

#### A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i bazuar revizioni i të paditurës K. e S. "S.", me seli në .., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.4741/2015, të datës 17.09.2019, në pjesën I të dispozitivit.

HUDHET si i pa lejuar revizionit i të paditurës K.e S. "S.", me seli në ..., paraqitu kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.4741/2015, të datës 17.09.2019, në pjesën II të dispozitivit.

Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.4741/2015, të datës 17.09.2019, në pjesën III,IV,V,VI, mbetet i pa shqyrtuar.

#### A r s y e t i m

Me pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr.4741/2015, të datës 17.09.2019, aprovohet pjesërisht si e themeltë ankesa e paditësve: N. A., J. A., A.A., B. A., A. A., që të gjithë nga fshati ... komuna e ..., NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr. 502/11, i datës 22.10.2015, në pjesën e dispozitivit të

aktgjykimit, lidhur me shumata e gjykuara për dhembje shpirtërore, shpenzimet e varrimit dhe ngritjes së përmendores, ndërsa gjykohet si në vijim: DETYROHET e paditura K. e S. "S.", me seli në ..., që për format e demit të cekur më lartë, paditëses N. A., në emër të dhimbjeve shpirtërore për vdekjen e bashkëshortit të saj, t'ia paguaj shumën prej 4.500 € , si dhe për demin material në emër të shpenzimeve të varrimit, shumën prej 1.000 € dhe në emër të ngritjes së përmendores, shumën prej 700 €, ndërsa paditësve J. A., A. A., B. A. dhe A. A., ti paguaj shumata si në vijim: për demin jo material, në emër të dhimbjeve shpirtërore për vdekjen e babait të tyre, për se cilin prej tyre, shumën nga 3,500€ të gjitha këto me kamatë të cilën e paguajnë bankat vendore si për deponimet për kursim me afat mbi një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë (22.10.2015) e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

Me pjesën II të dispozitivit, APROVOHET pjesërisht si e themeltë ankesa e të paditurës K. e S. "S.", me seli në ..., NDRYSHOHET pika III e dispozitivit, të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr. 502/11, i datës 22.10.2015, lidhur me shumata e gjykuara paditësit S. A., në emër të kompensimit të demit jo material dhe material, ndërsa gjykohet si në vijim: DETYROHET e paditura K. e S. "S.", me seli në ..., që paditësit S. A., ti paguaj këto shuma: në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 700 €, në emër të frikës së përjetuar shumën prej 500 €, në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj shumën prej 60 € si dhe në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 60 €, apo shumata e përgjithshme prej 1.320 € me kamat të cilën e paguajnë bankat vendore si për deponimet për kursim me afat mbi një vit pa destinim caktuar, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë (22.10.2015) e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

Me pjesën III të dispozitivit, pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësve: N. A., J. A., A. A., B. A., A. A., dhe S.A., të gjithë nga fshati ...komuna e ..., për kompensimin e demit jo material dhe demit material, nga shuma e aprovuar në pikën I të dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi e deri në shumën e kërkuar, REFUZOHET si e pa themeltë.

Me pjesën IV të dispozitivit, REFUZOHET si e pa themeltë ankesa e të paditurës K. e S. "S.", me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.502/11 datës 22.10.2015, në pjesën e gjykuar për shpenzimet e procedurës, VËRTETOHET.

Me pjesën V të dispozitivit, APROVOHET pjesërisht si e themeltë ankesa e paditëses Naime Ajvazi, nga fshati Zhegër Komuna e Gjilanit, PRISHET pika II e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr. 502/11 datë 22.10.2015 që ka të bëjë me pjesën refuzuese të kërkesëpadisë në emër të rentës, ndërsa për këtë pjesë çështja i kthehet të njëjtës gjykatës në rishqyrtim dhe vendosje.

Me pjesën VI të dispozitivit, pika VII e dispozitivit, të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.502/11 datës 22.10.2015, mbetet e pa shqyrtuar.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura në afat ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet e të dy gjykatave të prishen dhe lënda të kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Përgjigje në revizion ka paraqitur i autorizuari i paditësve me propozim që revizioni i të paditurës të refuzohet si i pa bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në bazë të nenit 215 të LPK-së, ka gjetur se:

Revizioni është pjesërisht i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se në aksidentin e komunikacionit të shkaktuar me datë 18.12.2008, në rrugën që shpie në drejtimin Zhegër-Gjilan, nga ana e Xh. R., drejtuesi i automjetit Opel kadet, me targa ..., i siguruar tek e paditura, jetën e ka humbur A. A., bashkëshorti dhe babai i paditësve, ndërsa S. A. në këtë aksident ka pësuar lëndime trupore. Nga certifikata e kurorëzimit dhe certifikatat e lindjes, vërtetohet se paditësi A. A., ka qenë bashkëshorti i paditëses N. A., ndërsa paditësit tjerë janë fëmijët e të ndjerit.

Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave ekspertizës të punuar nga eksperti i komunikacionit I. B., në shkurt 2009, ekspertizës së komunikacionit të punuar nga B. I., me 04.06.2015, dhe super ekspertizës së komunikacionit të datës 10.09.2012, ka vërtetuar faktin se, deri te aksidenti ka ardhur për shkak të lëshimeve të ngasësit të automjetit, përkatësisht të siguruarit të paditurës, i cili edhe pse ka vozitur në kuadër të shpejtësisë së lejuar, megjithatë nuk i është përmbajtur rregullës së paraparë me LMBSKRR, dhe nuk i është përshtatur kushteve të rrugës, duke mos i vërejtur këmbësorët me kohë, si dhe lëshimeve të këmbësorit (tani të ndjerit A. A.), i cili edhe pse ka qenë duke lëvizur në anën e majtë të rrugës, kundrejt lëvizjes së automjetit, nuk ka qenë duke lëvizur sa më afër skajit të rrugës, ashtu që

pika e kontaktit ka qen 1.15 m nga skaji i majtë, nga edhe rezulton baza juridike e kërkesëpadisë. Duke u bazuar në këto dy ekspertiza të komunikacionit , gjykata sipas bindjes së lirë, ka konstatuar se në këtë aksident të komunikacionit përgjegjësia është e ndarë 50% me 50%. Për lartësinë e kërkesëpadisë për paditësin S.A., gjykata është bazuar në konstatimin dhe mendimin e eksperteve mjekësorë, Dr. S. M. – ortoped dhe Dr. Q. R. – psikiatër. Ndërsa në shumat e gjykuara për paditësit tjerë është marrë për bazë edhe kontributi i këmbësorit dhe të gjitha rrethanat tjera . Ndërsa konform dispozitave nga nenin 185 dhe 200 të LMD-së, e duke u bazuar në përgjegjësinë e ndarë, paditëses N. A. në emër të dhimbjeve shpirtërore, për shkak të humbjes së bashkëshortit A. A. ,i ka pranuar shumën prej 3.000.00 €; në emër të shpenzimeve të varrimit, shumën prej 750.00 €; në emër të ngritjes së përmendores, shumën prej 500.000 €; të gjitha këto në shumë prej 4.250,00 €, me kamatë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses mbi shumat e gjykuara. Paditësit S. A.: për dhimbje të përjetuara ka gjykuar shumën prej 1.000,00 €, për frikën e përjetuar shumën prej 1.700,00 €; në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj shumën prej 200,00 € në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 200,00 €, të gjitha këto në shumë totale prej 3.100,00 €, me kamat si në dispozitiv të aktgjykimit, ka refuzuar si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësit S. A., mbi shumat e gjykuara. Në pikën V ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit J., A., B. dhe A. A.: për dhimbje shpirtërore shumat në bazë të përgjegjësisë së ndarë në aksidentin e komunikacionit 50%, ka pranuar shumën nga 2.500,00 €, për se cilin prej tyre, me kamatë si në dispozitiv të aktgjykimit, ndërsa ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësve mbi shumat e gjykuara. Ndërsa, në pikën VII të dispozitivit, ka vërtetuar se është tërhequr padia e paditësve N. A., J. A., A. A., B. A.,A. A., dhe S. A., ndaj të paditurit Xh. Rr., nga fshati ...

Gjykata e Apelit në procedurën e ankimimit, ka aprovuar pjesërisht si e themeltë ankesa e paditësve dhe ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për demin e gjykuar paditëses N. A., në emër të dhimbjeve shpirtërore për vdekjen e bashkëshortit të saj, si dhe për demin material në emër të shpenzimeve të varrimit dhe në emër të ngritjes së përmendores, si dhe shumat e gjykuara për demin jo material paditësve tjerë për vdekjen e babait të tyre, duke gjykuar shumat si në pjesën I të dispozitiv të aktgjykimit. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë, në këtë pjesë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë me zbatimin e gabuar të nenit 200 të LMD-së, kur ka gjykuar forma të demit jo material për dhimbje shpirtërore si në pjesën II të dispozitivit, pasi që shumat janë të ulta dhe nuk u shkojnë përshtati synimeve dhe qëllimeve shoqërore dhe për këtë arsye gjykata aprovoj pjesërisht ankesën e paditësve , ndryshoi

aktgjykimin në pjesën e gjykuar në emër të dhimbjeve shpirtërore të paditëses N. A. etj, dëmi material për shpenzimet e varrimit për shpenzimet e varrimit dhe ngritjen e përmendores dhe gjykoj si në pjesën I të dispozitivit duke vlerësuar se shumat e aprovuara nga gjykata e shkallës së parë për format e kompensimit të dëmit jo material për dhimbje shpirtërore nuk bazohen në kriteret e zbatueshme për vlerësim ,as praktikën gjyqësore të krijuar nga Gjykatat e Kosovës për këto forma të shpërblimit të dëmit dhe as me llojin e të mirave të dëmtuara. Gjykata vlerëson se tani shumat e gjykuara si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës janë adekuatë me kriteret dhe qëllimin e përcaktuar me nenin 200 të LMD-së. Në këtë drejtim, Gjykata e Apelit e ka vlerësuar si të gabuar mënyrën e ndarjes së përgjegjësisë , përkatësisht kontributit të ngasësit të automjetit dhe tani të ndjerit në shkaktimin e aksidentit .Kjo për faktin se, mënyra se si është hartuar ekspertiza e ekspertit të komunikacionit Besim Ibrahim, caktuar në procedurën civile ,si dhe sqarimet shpesh të dhëna nga ky ekspertë në shqyrtimin kryesor të datës 02.09.2015, përmes së cilave është arritur në përfundim se lëshimet kryesore me rastin e shkaktimit të aksidentit kanë qenë të ngasësit të automjetit ( të siguruarit të paditurës),janë plotësisht të pranueshme dhe në përputhje me prova materiale .Në anën tjetër , e njëjta ekspertizë nuk ka ndonjë dallim esencial me super ekspertizën e punuar për nevoja të procedurës penale .Mbi këtë bazë ,Gjykata ka vlerësuar se shumat e gjykuara për paditësit në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të vdekjes së familjareve të tyre, shpenzimet e varrimit dhe ngritjes së përmendores kanë qenë të ulta dhe jo në përputhje me përgjegjësin dhe kontributin në shkaktimin e aksidentit të siguruarit të paditurës.

Ndërsa pjesa e dispozitivit të aktgjykimit me të cilën është vendosur për pjesën e kërkesëpadisë së paditëses N. A., për pagimin e rentës, gjykata e Apelit vlerësoj se një vendim i tillë është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.n),LPK-së, vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike ,si rezultat i së cilës është zbatuar gabimisht edhe e drejta, për çka kjo pjesë është prishur dhe çështja është kthyer në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Në anën tjetër, Gjykata e Apelit i ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e të paditurës për shumat e gjykuara të dëmit jo material dhe material për paditësin S. A., e ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me shumat e gjykuara për këto forma të dëmit dhe ka gjykuar si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit. Ndërsa, ka refuzuar si të pa themeltë ankesën e të paditurës, në pjesën e gjykuar për shpenzimet e procedurës. Ka aprovuar pjesërisht si të themeltë ankesën e paditëses N. A., që ka të bëjë me pjesën refuzuese të

kërkesëpadisë në emër të rentës. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë në pika VII e dispozitivit, ka mbetur e pa shqyrtuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së dytë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që gjykata e shkallës së dytë drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar dhe se e paditura ka përgjegjësi për kompensimin e dëmit të cilin paditësit e kanë përjetuar me humbjen e anëtarit të ngushtë të familjes gjegjësisht bashkëshortit dhe babait të tyre. Aktgjykimi i goditur nuk përmbajë shkelje thelbësore të procedurës kontestimore, të cilat kjo Gjykatë i vlerëson sipas detyrës zyrtare. Gjykata e shkallës së dytë, në aktgjykimet e saj ka dhënë arsye të mjaftuara për faktet vendimtare për gjykimin e drejtë të kësaj lidhur me ndarjen e përgjegjësisë përkatësisht kontributin e drejtuesit të automjetit dhe tani të ndjerit në shkaktimin e aksidentit. Kjo për faktin se, nga ekspertiza e ekspertit të komunikacionit B. I., si dhe sqarimet shtesë të dhënë nga ky ekspert në shqyrtimin kryesor të datës 02.09.2015, del se lëshimet kryesor me rastin e shkakimit të aksidenti kanë qenë të ngasësit të automjetit, të siguruarit të paditurës. Në anën tjetër, e njëjta ekspertizë nuk ka ndonjë dallim esencial me superekspertizën e punuar për nevoja të procedurës penale. Në këtë drejtim për shkak të këtyre lëshimeve, i siguruari i të paditurës është ndjekur penalisht dhe është shpallur fajtor nga gjykata penale. Mbi këtë bazë, gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se përgjegjësia e të paditurës nga gjykata e shkallës së parë, nuk është vlerësuar drejtë, kështu që shumat e gjykuara kanë qenë të ulëta dhe jo në përputhje me përgjegjësinë dhe kontributin e të siguruarit të paditurës.

Gjykata Supreme po ashtu vlerëson se shumat e gjykuara të dëmit jo material dhe material paditësve N. A., J. A., A. A., B. A., A. A., me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë janë reale, dhe në përrudhje me shkallën e përgjegjësisë të paditurës të vërtetuar nga ana e ekspertëve të komunikacionit. Gjatë caktimit të lartësisë së shpërblimit për format e caktuara të dëmit jomaterial, gjykata e shkallës së dytë sipas nenit 200 të LMD, është kujdesur për rëndësinë e të mirës së dëmtuar dhe qëllimit të cilit i shërben ai shpërblim, por edhe për çështjen që të mos favorizohen synimet të cilat nuk janë në përputhje me natyrën e shpërblimit të tillë të dëmit jo material dhe qëllimin shoqëror. Duke pasur parasysh kriteret e parapara me këtë dispozitë, dhe duke u bazuar në nenin 323 të LPK-së, kjo Gjykatë vërteton se kompensimi i dëmit jo material i gjykuar nga gjykata e shkallës së dytë është real dhe paraqet shpërblim të drejtë dhe një formë të satisfacionit për paditësit dhe është në përputhje me praktikën e gjertanishme të gjykatave në Kosovë. Po ashtu edhe shumat e gjykuara paditëses N. A., në emër të dëmi material për

shpenzimet e varrimit dhe ngritjen e përmendores, janë reale dhe janë caktuar në bazë provave materiale.

Prandaj nuk qëndrojnë pretendimet në revizion se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, për lartësinë e shumave të gjykuara në emër të kompensimit të dëmit jo material dhe material . Ndërsa, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se, gjykata e shkallës së dytë në arsyetim të aktgjykimit ka dhënë arsye të plota dhe të mjaftueshme për themelësinë e kërkesëpadisë, përgjegjësinë e të paditurës për kompensimin e dëmit si dhe rrethanat që lidhen me kategorinë dhe lartësinë e shumave të gjykuara për çdo formë të dëmit. Kështu që pretendimet në revizion nuk e vejnë në pyetje ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së revizionit të paditëses sipas dispozitës së nenit 220 lidhur me nenin 211.2 të LPK-së, lidhur me shumat e gjykuara të dëmit jo material dhe material paditësit S.A., në shumë të përgjithshme prej 1320 €, ka gjetur se revizioni i të paditurës është i palejuar, në kuptim të dispozitës së nenit 211.2 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK) ku parashikohet që:” revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadija ka të bëjë me kërkesat në holla, me dorëzimin e sendit apo me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po qe se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur nuk e kalon shumë prej 3.000€”. Duke pas parasysh faktin se me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë paditësit S. A., për të gjitha format e dëmit i është gjykuar shuma e përgjithshme prej 1320€, kjo shumë e gjykuar nuk e kalon shumë prej 3.000 €, që do të thotë se revizioni i të paditurës nuk është i lejuar në bazë të nenit 211.2 të LPK-së, pasi që vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur nuk e kalon shumë prej 3.000€, dhe si i tillë duhet të hedhet poshtë.

Në bazë të asaj që u tha e me zbatimin e nenit 222 e lidhur me nenin 221.2 të LPK-së, u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË**

**Rev.nr.3/2020, më 3.3.2020**

**Kryetare e kolegjit**

**Gyltene Sylejmani**